



**Për: Mediat e shkruara dhe elektronike**  
**Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim**  
**Subjekti: Deklaratë**

---

*Prishtinë, 20 shkurt 2008*

## **Deklaratë**

Aleanca Kosova e Re, me respekt dhe mirënjohje të thellë, falënderon, të gjitha ato shtete, që tashmë kanë njohur Pavarësinë e Kosovës, duke besuar se shumë shpejt do të vendosen edhe lidhje diplomatike në nivel Ambasadorësh, me këto vende. Procesi i njohjes së shpejtë të Kosovës, si Shtet i Pavarur dhe Sovran, është i një rëndësie jashtëzakonisht të veçantë, prandaj ne besojmë fuqishëm, se në ditët në vijim, Kosova do të njihet nga shumica e vendeve të Botës.

AKR, përgëzon të gjithë qytetarët e Kosovës për maturinë dhe pjekurin që treguan gjatë festimit në Ditën e Shpalljes së Pavarësisë, dhe në ditët në vijim. Nivelin e qytetërimit, që u tregua me këtë rast nga kosovarët, ishte për t'u çmuar dhe vlerësuar lartë.

Kosova do t'u jetë gjithmonë mirënjohëse, shteteve që në vazhdimësi, sikurse deri me tash, po mbështesin Kosovën dhe institucionet e saj. Ne i garantojmë miqtë tanë se Kosova, do të dëshmojë, edhe në të ardhmen, nivel të lartë të tolerancës, barazisë dhe do të jemi gjithmonë të hapur për bashkëpunim, veçanërisht në procesin e integrimi të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Njohja e Kosovës shtet i Pavarur nga SHBA dhe vendet më të zhvilluara në Botë, është një tregues i mirë i të ardhmes Euroatlantike të Kosovës. Vendosmëria e miqve tanë, për ta ndërtuar Republikën e Kosovës, si shtet demokratik, është dhe vazhdon të jetë ndihmesa më e madhe që i bëhet vendi tonë, në këtë fillim të ekzistimit si Shtet i Pavarur.

Aleanca Kosova e Re, dhe Kryetari Behgjet Pacolli janë të vendosur për të ardhmen evropiane të Kosovës, duke qenë të bindur se krahas stabilitetit që po vendoset në Ballkan dhe në Evropën jug-lindore, Kosova do të thelloj nivelin diplomatik të bashkëpunimit me të gjitha vendet që tashmë kanë njohur mëvetësinë e vendit tonë. Ne do të jemi të hapur për bashkëpunim edhe me vendet e tjera, të bindur, se edhe ato do të jenë, shumë shpejtë, të renditura në anën e vendeve që tashmë kanë njohur Shtetin më të ri në Botë, Kosovën.

**Aleanca Kosova e Re**